



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosova

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Mbledhja nr.14/24

Prishtinë, më 28.6.2024 dhe 17.7.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Pal Lekaj dhe Duda Balje.

Munguan: Ferat Shala, Avdullah Hoti.

Të ftuar: Besnik Boletini, kryesues i Bordit, RTK, Shkumbin Ahmetxhekaj, drejtor, RTK, Fatime Lumi-Qehaja, anëtare e Bordit, RTK, Arta Berisha, anëtare e Bordit, RTK, Dardan Beqiri, anëtar i Bordit, RTK, Gazmend Rexhaj, zyrtar kryesor financiar, RTK, Safet Kabashaj, anëtar i Bordit, RTK.

Pjesëmarrësit tjerë: Sanije Berisha, OSBE; Elsa Krasniqi, GP LVV; Anduena Shtavica, GP LDK; Ema Krasniqi, monitoruese, KDI; Arbana Hajredinaj, gazetare, RTK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit të Komisionit funksional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2025, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve 2025/01**

4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2023;
5. Shqyrtimi i programit të shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik - dhjetor 2024;
6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2023;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i raportit të Komisionit funksional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Kryetari: Projektligji nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, është shqyrtuar nga Komisioni funksional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komision ka dërguar raportin (pa amendamente).

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore mbi planifikimet buxhetore të parapara me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës (për vitin 2023 dhe planifikimin për vitin 2024-2025). Të gjitha aktivitetet do të mbulohen nga ndarjet buxhetore aktuale të programi Agjencia Kadastrale e Kosovës, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës nuk përmban implikime buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2025, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve 2025/01

Kryetari: Në bazë të nenit 19, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia miraton Projektbuxhetin e Kuvendit, që përgatitet nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bashkëpunim me Administratën e Kuvendit. Për të prezantuar dhe arsyetuar kërkesat buxhetore të Kuvendit për vitin 2025, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave 2025/1, e kemi të ftuar zëvendës-sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, z. Arben Loshi, të cilit ia kalojmë fjalën.

Arben Loshi: Planifikimi i buxhetit për vitin 2025, bazohet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027, që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2025-2027. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal, të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2025-2027, sipas prioriteteve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar nëpërmjet Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe strategjive sektoriale, si dhe dokumentet që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, sikurse Programi për Reforma në Ekonomi 2024-2026 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Rrjedhimisht, prioritetet e Qeverisë për periudhën e ardhshme trevjeçare janë fokusuar në riorientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjes së punësimit dhe një zhvillimi të qëndrueshëm, që mbron ambientin duke e ruajtur atë edhe për gjeneratat e ardhshme, si dhe orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale të KASH 2025-2027, kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027.

Çdo tendencë për tejkalim të kufijve të shpenzimeve mbi kufijtë e kësaj qarkoreje, e bën të detyrueshëm ndryshimin përkatësisht rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2025/01, është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negociim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Pal Lekaj: Sa i përket kërkesës suaj, janë legjitime dhe duhet që të mbështeten, por ajo që më beri përshtypje është blerja e tri veturave. Pse gjithë ajo shumë, e përmendët shumën 70 mijë, në shërbim të kujt janë ato vetura?

Arben Loshi: I nderuar deputet, ato vetura janë propozuar të blihen për Komisionaren e FSK-së, e cila është zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, por ajo akoma nuk ka administratë. Fatkeqësisht, akoma nuk është miratuar rregullorja për organizimin dhe funksionimin e zyrës.

Kryetari konstatoi se pas përfundimit të diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2025, sipas dokumentit të bashkëngjitur këtij rekomandimi dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025.

4. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik - dhjetor 2024

Kryetari: Në bazë të nenit 11, paragrafi 11 të Ligjit nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, për periudhën korrik - dhjetor, Radiotelevizionit të Kosovës (në tekstin e mëtejme RTK), i ndahen katër milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë euro (4,480,000 euro), në kategorinë e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.

Sipas nenit 11, paragrafi 11 të Ligjit të Buxhetit për vitin 2024, para secilit gjashtë (6) mujor, RTK-ja do të dorëzojë në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, (Kuvend), programin e shpenzimeve të planifikuara, ndërsa në fund të çdo gjashtë (6) mujori, RTK-ja do të dorëzojë në Kuvend raportin për shpenzimet e bëra. Mjetet sipas këtij paragrafi alokohen dhe transferohen nga Thesari, në llogarinë e përcaktuar nga RTK-ja në bankë komerciale, sipas vendimit të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere.

RTK, për periudhën korrik - dhjetor 2024, ka dorëzuar Programin e shpenzimeve (kërkesën) për ndarjen e mjeteve buxhetore në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere.

Ftoj kryetarin e Bordit të RTK-së, z. Besnik Boletini, që ta arsyetojë Programin e shpenzimeve (kërkesën) e RTK-së për periudhën korrik - dhjetor 2024.

Besnik Boletini: Sa i përket performancës financiare për vitin 2023, po e bëj një përmbledhje të shkurtër. Gjatë vitit 2023, të hyrat në RTK kanë qenë 10 670 000,00€, ndërsa shpenzimet e përgjithshme 10 547 00,00€. Për pagesën e stafit 8 151 00.00€, në krahasim me vitin paraprak, janë 150 000,00€ më pak, ndërsa për shpenzime operative dhe programe 1 455 000,00€, në krahasim me vitin e kaluar, janë 300,000.00 më pak. RTK, për herë të parë, ka njohur detyrimet kontingjente sipas vendimit të gjykatës. Kjo shumë e njohur, si shpenzimeve të vitit 2003, ka qenë 374 mijë euro, duhet theksuar patjetër që përveç në angazhimet përpos një menaxhim sa më të mirë financiar dhe kontroll financiar, është ballafaquar dhe këtë vit me çështjen e borxheve të vjetra, për shembull gjatë vitit 20123, janë tërhequr nga përmbaruesit përmes vendime të gjykatave 65 mijë 625 euro, e cila e ka pasur ndikimin e vet në likuiditetin e institucionit, kurse në vitin 2024, gjendja është edhe më keq, ku deri më tani i kemi 189,715, që janë tërhequr përmes përmbaruesve, për shkak të vendimit të gjykatave. Po ashtu, shtojmë faktin se kemi edhe shpenzime shtesë për këto lëndë, që janë të vjetra, pjesë e kamatës e cila shumë duhet të paguhet për vitet 2012-2013, që ka fituar, pastaj pala po ngarkohet edhe me një pjesë shtesë nga gjithë kjo, pra totali për 2023 dhe 2024, deri në këto momente kur po flasim, është 255,341.00, marrë nga përmbaruesit. Sa i përket borxheve para vitit 2008, të cilat janë të regjistruar në sistemin e kontabilitetit, janë 648294.00, deri më datë 31.5. 2024, si dhe të provizionuar në proces në gjykatë janë 400 mijë euro. Pra, totali i detyrimit, që janë 1 milion e 48294 euro, aktualisht. Siç e theksova, si pasojë e mospagesës së këtyre borxheve në rritje, shpenzime për kamatat dhe të interesave, ku për shumën totale prej 255 341 mijë euro, janë paguar 40,389.00 euro, në total, si interesa për kamatë. Kështu që, në këtë mënyrë, kemi një rrezikim prej përmbaruesve, sepse po na rrezikon sistemin buxhetor privat.

Pal Lekaj: Këto para që i ndan Kuvendi, duhet të shfrytëzohen në mënyrë të drejtë dhe ligjore. Në të gjeturat e ZKA-së, është mjaft shqetësuese pasqyra financiare, shpenzueshmëria e tyre, sepse ka mjaft çështje që duhet të diskutohen.

Eman Rrahmani: Jam i interesuar, që të më shpjegoni pikën 1.4-shpenzimet në bord, honorarët e anëtarëve të bordit, anëtarëve të komitetit dhe të anëtarëve të grupit këshillues.

Shkumbin Ahmetxhekaj: Janë pagat mujore, që paguhet anëtarët e bordit për çdo muaj.

Visar Korenica: Një sqarim rreth listës për punëtorët që kanë konflikt interesi me RTK-në, janë diku rreth 100 emra.

Besnik Boletini: E kemi marrë raportin e ZKA-së dhe do ta adresojmë secilën gjetje.

Visar Korenica: Pyetja tjetër është për zëvendësdirjtorin e RTK-së, nuk e dimë me çfarë rregulloreje, i njëjti përdor makinë të RTK-së për ta sjellë prej Tirane në Prishtine dhe anasjelltas, kur e dimë që veturat e RTK-së përdoren vetëm për qëllime zyrtare.

Shkumbin Ahmetxhekaj: Kjo praktikë tashmë është adresuar dhe është ndaluar.

Enver Haliti: Kam një pyetje, te mirëmbajtja ose qiraja e veturave, ku keni planifikuar vlerën prej 47 mijë euro, a e keni shqyrtuar ndonjëherë mundësinë për shkëputjen e këtyre kontratave?

Besnik Boletini: Po, e kemi diskutuar këtë çështje në disa mbledhje dhe parimisht jemi dakorduar që RTK-ja duhet t'i blejë veturat.

Eman Rrahmani: Shikojeni mundësinë e blerjes së veturave elektrike, e që kanë shumë kosto të ulët të mirëmbajtjes, e që është në dobi të RTK-së, apo ta merrni në konsideratë edhe mundësinë e lizingut.

Kryetari: Keni shpenzime të larta të energjisë elektrike. Kam informacion që në RTK ekziston një postë, ku mbushen me rrymë veturat eklektike të punëtorëve. A është e vërtetë kjo?

Shkumbin Ahmetxhekaj: Nuk është e vërtetë që ekziston një poste, është një rast individual për të cilin kemi marrë masa.

Kryetari: Ju lutem, ma dërgoni komplet dosjen e këtij rasti.

Kryetari: Sa i përket numrit të punëtorëve në RTK, unë kam kërkuar nga ATK, një numër të saktë të punëtorëve të RTK-së, dhe përgjigjja që kam marrë nga ATK, është në mospërputhje me raportimet tuaja. Pse është duke ndodhur kjo?

Shkumbin Ahmetxhekaj: Në vitin e kaluar, në Festivalin e Këngës, kemi pasur të angazhuar 140 veta, që kanë pasur kontratë me RTK-në (instrumentistë, këngëtarë, te ftuar), dhe në momentin që RTK-ja bën një pagesë, për ta regjistrohesh edhe në ATK, por nuk do të thotë që ata janë punëtorë të RTK-së.

Mërgim Lushtaku: A ka konflikt interesi në emërimin e zëvendësdirjtorit të RTK-së, cilat janë sanksionet që i keni ndërmarrë për zëvendësdirjtorin, lidhur me shkeljen e rregullores, lidhur me përdorimin e veturës jashtë detyrës zyrtare?

Besnik Boletini: E kemi dërguar lëndën në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe agjencia na ka thënë se nuk ka konflikt të interesit, sa i përket emërimit të zëvendësdirjtorit të RTK-së.

Kryetari, pas përfundimit të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

VENDIM

1. Miratohet Programi i shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik - dhjetor 2024, në shumë prej 4,480,000 euro (katër milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë euro).
2. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në Ministrinë e Financave, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në buxhetin e Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr.1110-10121906-0187, për periudhën korrik - dhjetor 2024, në shumë prej 4,480,000 euro (katër milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë euro).
3. Radiotelevizioni i Kosovës, në kuadër të shumës së mjeteve nga pika 1 e këtij vendimi, të realizojë shlyerjen e detyrimeve ndaj Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari deklaroi se pikat tjera, të shtyhen për mbledhjen e radhës. Po ashtu, pyeti se a ka diçka në pikën të ndryshme. Meqë nuk pati, e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Vazhdimi i mbledhjes së datës 28.6.2024

Datë: 17.7.2024, ora 11:00

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti dhe Pal Lekaj.

Munguan: Ferat Shala, Mërgim Lushtaku dhe Duda Balje.

Të ftuar: Hekuran Murati, ministër i Financave, Punës dhe Transfereve.

Pjesëmarrësit tjerë: Diellëza Gashi, Ema Krasniqi, KDI; Drin Demiri, Klan Kosova; Argjentina Shala, Kosovapress; Arbëresha Berisha, RTK; Nexhmije Ahmeti, zyrtare për media, Kuvend; Pleurat Salihu, gazetar, gazeta "Demos".

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare për vitin 2023;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2023;
9. Të ndryshme.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023

Kryetari: Kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar në mbledhjen e datës 10.7.2024, por jemi dakorduar që të vazhdojmë me shqyrtimin e kësaj pike edhe në këtë mbledhje. Për këtë pikë kemi ftuar ministrin e Financave, z. Hekuran Murati, që ta arsyetojë raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Hekuran Murati: Viti i kaluar ka shënuar rritje të hyrave direkte dhe indirekte, në aspektin e të hyrave tatimore të të **ardhurave të korporatave**, ka pasur rritje 16%, në krahasim me vitin paraprak. Të hyrat janë 185 milionë €, krahasuar me 160 milionë €, me vitin paraprak. Tatimi në të ardhura personale, rritja ka qene 18%. Me këtë konfirmon se ka pasur rritje të punësimit dhe rritje të pagave mesatare. **Tatimi nga të ardhurat personale** ka qenë 256 milionë €, në krahasim me 215 milionë të vitit paraprak. **Tatimi në pronë**, kemi performancë më të mirë, krahasuar me vitin paraprak, 46 milionë €, në krahasim më 34.5 milionë € të vitit paraprak. Tatimet indirekte, tatimi mbi vlerën e shtuar ka shënuar rritje 12%, ndërsa në përgjithësi, tatimet indirekte përfshirë detyrimin doganor, akcizën, tatimet indirekte, rritja shënon 11%. **Inflacioni** në vitin e kaluar ka qenë 5%, ndërsa të hyrat nga tatimi në vlerën e shtuar kanë shënuar 12%. **Shpenzimet - paga dhe shitesa**, shpenzimi i përgjithshëm për vitin e kaluar ishte 767 milionë €, krahasuar me 653 milionë € të vitit paraprak. Pra, krahasuar me vitin paraprak, është një rritje prej 114 milionë € më shumë apo 17.4% rritja mesatare e pagave. **Mallra dhe shërbime** ka po ashtu ritëm të rritjes. Rritja më e madhe te kategoritë e shpenzimeve, sidomos te shpenzimet kapitale, ku gjithsej janë shpenzuar 561 milionë €, krahasuar me 422.6 milionë € të vitit paraprak, që i bie një rritje prej 33 % në terma krahasues. Sa i përket **deficitit dhe bilancit buxhetor**, viti është mbyllur me një deficit prej 22.5 milionë €, që paraqet 0.23% të GDP- së, ndërsa sa i përket borxhit, kemi stabilizim sikurse në vitet paraprake. Në vitin 2023 kemi pasur rënie të borxhit publik, që ka rezultuar që borxhi publik ndaj GDP -së të bie prej 17.5% nga 20%, që e kemi marrë.

Avdullah Hoti: Të ardhurat e korporatave, këtu ka pasur një rritje nga 159 në 184 milionë €. Nëse e sheh rritjen e fitimit të bankave, kjo është rezultat i fitimit të bankave, pastaj vijmë te pjesa e korporatave, nëse e sheh rritjen e fitimet të bankave, i bie që krejt kjo rritje është rezultat i fitimit të bankave, fitime të deklaruar nga ana e bankave, që i bie korporata etj. Në Kosovë, ndoshta kanë pasur edhe zvogëlim të tatimit që kanë paguar për shtetin, duke pasur parasysh këtë element kur interpreton këtë, tatimi në pronë, por nuk është si rezultat i rritjes së shkallës së pagesave, por ka pasur rritje enorme të ngarkesave tatimore nga tatimi në pronë. Këtë ngarkesë tatimore qytetarët praktikisht kanë paguar 12 milionë më shumë, sepse ua ke rritur faturat. Me ligjin paraprak, toka bujqësore, kur është e punueshme, nuk tatóhet. Tatimi në vlerën e shtuar, në faqen gjashtë, është rritur, janë dyfishuar importet krahasuar me vitin 2020-2021. Ne importojmë 2 miliardë mallra nga jashtë. Devidenta nga KEK-u, në vitin 2020 janë paguar 10 milionë €, s'ka pagesa të devidentes.

Të hyrat nga AKP-ja 39 mijë, nuk ka në 2021 të hyra nga AKP- ja, në këto 3 vitet e fundit. Te pagat dhe shitesat, përgjysmimi i pagesave për sindikatat, sot punëtorët paguajnë 864 mijë € për vitin 2023, krahasuar me 1.9 milion, sa kanë paguar në vitin 2021.

Mallrat dhe shërbimet – mobile më pak se 1 mijë €, gjë që janë kritikuar qeveritë e kaluara. Në vitin 2023 janë paguar 3.1 milionë €, krahasuar me 1.5 milion €, që kanë qenë në vitet e mëhershme.

Blerjet shtetërore - 21 milionë €, nuk kemi informatë çka ka ndodhur me blerjet e rezervave shtetërore (8.9 milionë € në vitin 2023, 10.2 milionë € në vitin 2022, 474 mijë € në vitin 2021, total = 21 milionë €). Avancë për mbrojtje dhe siguri- 31 milionë €. Qiraja në ndërtesa - 34 milionë €, në këto 3 vite të fundit. Drekat zyrtare- 1.9 milion €, kanë qenë në vitin 2021 ndërsa 3.2 milion € 2023 i kemi sot. Vendimet e gjykatave – janë paguar nga mallrat dhe shërbimet 22 milionë € në këto 3 vitet e fundit (në vitin 2022, 4.8 milion €, në vitin 2023 7.4 milion €). Pagesa për vendime të gjykatave. Subvencionet dhe transferet 520 milionë € janë paguar për entitete publike në këto 3 vite të fundit (185 milion € në vitin 2023, 233 milion € në vitin 2022 dhe 102 milion € në vitin 2021).Shpenzimet kapitale 263 mijë € për telefona kanë qenë 0 në vitin 2021, kanë qenë veç 3 mijë € në vitin 2022, ndërsa tash 263 mijë €. Avanca për investime- kanë shkuar në 60 milionë € në vitin 2023, në krahasim me 1milion €, 2 milionë € dhe 4 milionë €, sa kanë qenë në qeveritë e mëparshme. Ndërsa, në këto 3 vitet e fundit, ka shkuar në 165 milionë €. Pagesa për vendime gjyqësore 65 milionë €, në këto 3 vite. Kompensimi për inflacionin 8.5 milionë u janë paguar kompanive private për rritjen e normës së inflacionit për materialet ndërtimore.

Hekuran Murati: Fitimi i bankave në vitin 2022 dhe 2023, shtimi i fitimit në banka në 300 milionë, është e pavërtetë. Jepni fakte dhe dëshmi. Tatimi në pronë, ligji që është sponsorizuar edhe nga ju, sa keni qenë në qeveri, pastaj ishte miratuar nga qeveria pasuese. Ligji e parasheh rivlerësimin periodik të pronave, nuk ka pasur rritje të tatimit. Të hyrat që janë mbledhur kanë shkuar në komuna. Pretendimi që TVSH-ja është rritur, sepse është dyfishuar importi, nuk qëndron. Nëse tatimi në fitim është 10% e fitimit është rritur për 30 milionë €. Kjo i bie që fitimi është rritur për 300, 10% është 30 milionë €. Devidenta e KEK-ut, në vitin 2021 kemi kërkuar si qeveri 10 milionë nga KEK-u të, deklarojë pagese të dividendës.

Avdullah Hoti: Nuk është e prezantuar në KASH. Pra, kjo që po thua, nuk është e prezantuar në raportin vjetor të ndërmarrjeve publike, por nuk e ke politikë qeveritare edhe në kornizën afatmesme shpenzimeve 2025 – 2027.

Hekuran Murati: Në vitin 2021, kur kemi marrë dividendë nga KEK- u, ka qenë e shënuar si pjesë tekstuale që KEK-u do të paguajë dividendë në vitet pasuese, nuk e kemi përfshirë.

Të hyrat nga AKP-ja, në vitin 2021, janë pranuar 39 mijë €, fondi i AKP-së ka qenë mbi 600 milionë €, të mbledhura nga shitja rreth 450 milionë €, prej tyre tashmë janë shfrytëzuar nga qeverisjet e kaluara. D.m.th. janë tërhequr dhe janë shpenzuar për të mbuluar shpenzimet buxhetore, ndërsa shuma e mbetur është rreth 150 milionë €.

Çështja tjetër e ngritur nga deputeti ishte pagesat për sindikatë dhe tkurrja atyre, pra nga viti në vit, realisht çfarë ka ndodhur është që është digjitalizuar edhe deklarimi i anëtarëve të sindikatës, janë automatizuar pagesat. Për të evituar problemet që sindikata i ka futur në listë pa dijeninë e tyre, ne e kemi digjitalizuar, secili anëtar i sindikatës, që të hyjë në e- Kosova, të deklarojë në cilën sindikatë është anëtar dhe dëshiron që t'i paguajë kontributet.

Eman Rrahmani: Janë 2 perspektiva të problemit: përgjysmimi i kontributit dallon me ato çka ju po e thoni ,që ka pasur regjistrim të emrave të tyre në sindikata, pa vullnetin e tyre, mirëpo nuk

besoj që pagesa është bërë pa vullnetin e tyre. Çështja tjetër është fitimi i bankave në vitin 2020 edhe 2023, është dyfishim i fitimit në sektorin bankar, 79 milionë euro ka qenë në vitin 2020, në vitin 2023 janë 155 milionë €, në bazë të raportit të BQK-së.

Hekuran Murati: Që i bie 7.5 milionë euro janë tatim i mbledhur nga ai fitim.

Kryetari: Që i bie nga 7 ka kaluar në 15 milionë €. Nëse fitimi ka qenë 80 milionë dhe ka shkuar në 150 milionë, kjo do të thotë që nga 8 milionë.

Hekuran Murati: Të ardhurat nga korporatat kanë qenë 80 milionë, ndërsa ka shkuar në 180 milionë. Kjo d.m.th. që ka pasur nga 8 milionë, vetëm 10% e fitimit është marrë si tatim, ka shkuar në 180 milionë apo 15 milionë si tatim në fitim. Këtë rast 7 milion € kontribut, është sukses si rezultat i punës së mirë. Rritja këtu është 100 milionë €. Në 2020, tatimi i mbledhur në korporata ka qenë 80 milionë €, që i bie prej 80 në 180 milionë sa kemi tash.

Kryetari: Bizneset kanë pasur fitim 1.8 miliard €, në vitin 2023, krahasuar me 860 milionë €, sa kanë pasur në vitin 2020.

Hekuran Murati: Te rezerva shtetërore, u përmend gjithçka ka ndodhur, besoj ka pasur raportime të mjaftueshme për këtë çështje, është rritur buxheti dhe blerja për rezervat shtetërore. Buxheti vjetor ka qenë 300 mije euro, ne e kemi çuar në 10 milionë euro dhe vazhdojmë të ketë blerje për nevojat strategjike të vendit, sa i përket avancës për mbrojtje dhe sigurinë. Pra, qoftë mallra dhe shërbime, qoftë shpenzimet kapitale. Çështja tjetër ishte qiraja për ndërtesa. Ne, megjithatë, nëse vërehet në vitin 2023, ka një rënie prej vitit 2022. Ne kemi gjetur një situatë ku shumica e institucioneve dhe degët kanë qenë në ndërtesa me qira. Kjo merr pak kohë që të rregullohet, derisa të konsolidohen edhe institucionet, por edhe të ketë ndërtime e renovime të objekteve ekzistuese, mirëpo trendi besoj që është i mirë, sepse nëse në vitin paraprak ka qenë mbi 12 milionë €, tani kemi pasur 11.5.

Hekuran Murati: Edhe në vitin 2024, vendime të gjykatave që ekzekutohen për çështje të qeverive të kaluara, fillimisht janë kontratat kolektive të nënshtruara nga qeveritë e kaluara, me shkelje ligjore pa kurrfarë procedure dhe pa buxhetim, të cilat vetëm në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, prapë kanë marrë 41 milionë euro vendime të gjykatave për vitet e kaluara, që janë të qeverive të kaluara. Pra, asnjë kontratë e tillë kolektive nuk është nënshkruar këtë mandat, janë të gjitha nga qeveritë e kaluara, pastaj kjo shkakton probleme edhe te kapitalet, sepse kur një komune i merren mjetet për kontratë kolektive, nuk mund të paguajë shpenzimin kapital, meqenëse nuk ka qenë e buxhetuar sa duhet. Qeveria e Kosovës ka subvencionuar entitetet apo ndërmarrjet publike, p.sh. RTK-në, për 3 vite, është subvencionuar me 27 milionë, pastaj Fondi për Garanci Kreditore mbi 30 milionë.

Eman Rrahmani: Shpenzimet për udhëtimet zyrtare janë të larta, duke përfshirë edhe deputetët.

Hekuran Murati: Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, megjithatë kam disa sqarime nëpër vite. Në vitin 2015, ka qenë 9.6 milionë euro, të tjerat janë 10 milionë, pastaj për shkak të pandemisë ka ulje të shpenzimeve në përgjithësi. Në vitin 2023, shpenzuesi kryesor në kategorinë shpenzime zyrtare është FSK-ja, që përfshijnë trajnimet e ushtarëve, janë dërguar siç e keni parë 2000 ushtarë në trajnime, të cilët normalisht është regjistruar si shpenzime.

Eman Rrahmani: Kërkojmë një raport se sa është vlera e shpenzuar për ushtarët e FSK-së, prej vitit 2015 deri në vitin 2023.

Hekuran Murati: Mesatarja për vitet 2015-2019, te Ministria e Mbrojtjes, për këtë kategori, ka qenë 766 mijë euro, në vitin 2023 ka qenë 1 milion 779 mijë euro.

Pal Lekaj: Keni dhënë shifra të bollshme, por që nuk argumentohet në terren. Shpenzshmëria e shpenzimeve kapitale për vitin 2023, ka qenë 67 %, infrastruktura rrugore. Rruga në drejtim të Gjilanit, ku jemi dhe çka është bërë? Rruga Dollc - Gjakovë, sa janë shpenzuar, ku është ajo shifër, ku qëndron interesi i kësaj qeverie, që të mos zhvillohen këto projekte? Po ashtu, rruga për Mitrovicë, Podujevë. E përmende Infrakos-in, projektin hekurudhor të korridorit të 10-të, ka pasur të përfundojë që 2 vite. Sa janë shpenzuar? 5 vite është me vonesë dhe prapë do të ballafaqoheni me arbitrazhin. Fondi shpenzime të pagave bruto është rritur përafërsisht 113 ,960.000€ apo 15%, jo 17 siç e potencove ti. Investimet kapitale, intensiteti nuk është shtuar fare. Në vitin 2023 shohim se borxhi publik i përgjithshëm është 1 miliard e 663 milionë euro, ku prej tyre 692milionë e 350 mijë euro apo 42% janë të bordit ndërkombëtar. Do të thotë, që nga projekte të ndryshme, ku është realizimi i tyre, ku kanë filluar, çka është bërë në tokë dhe a jemi afër? Sa i përket të dhënave të punësimit qendror, për shembull, numri i aprovuar i të punësuarve për nivelin qendror ka qenë 43,809 pozita, përderisa numri aktual në fund të vitit 2023 ishte 39,740 pozita. Kemi diferencë të numrit të punësuar aktual buxhetor për 4 mijë e 69 pozita. Kjo është neglizhencë e juaja. Në vitin 2023, me vendime të gjykatave dhe vendime të përmbauesve privatë, janë bërë pagesa në shumë prej 51.9 milionë euro. Ju keni ndërprerë kontratën e “Contur Global” dhe e keni dëmtuar buxhetin e Kosovës 21 milionë dhe ne prapë importojmë energjinë, prapë ka telashe në KEK. Kemi import edhe të prodhimeve bujqësore. Qytetarët tanë jetojnë më keq se para 4 viteve, janë larguar 200 mijë qytetarë.

Eman Rrahmani: Shumë shqetësuese për vendin është statistika për njerëzit të cilët e kanë lëshuar Kosoven. Numri që është paraqitur, është shifër e gabuar, sepse shifra e atyre që janë larguar nga vendi, në bazë të statistikave nga Enti Statistikor, është mbi 500 mijë.

Hekuran Murati: Nëse e krahasojmë vitin 2011 me vitin 2024, shihet diku 150 mijë si numër më pak. Së fundmi, bashkë me Kryeministrin dhe Ambasadën Amerikane, me mbështetjen e USAID-it dhe në bashkëpunim me Fondin për Garanci Kreditore, lansuam edhe masën për garantimin e kredive investuese për diasporën.

Eman Rrahmani: Ky është një trend që është problematik për vendin, jemi në situatën ku nataliteti është më i vogël sesa në Serbi. Nëse nuk ka njerëz në këtë vend, nuk ka as shtet. Fondet të cilave jeni duke iu dhënë mbështetje, të organizatave që ndikojnë në pakësimin e shtimit të familjes, ato fonde jepni për ndikimin e shtimit të natalitetit.

Hekuran Murati: Kemi marrë hapa dhe veprime dhe ka rezultat. Në vitin 2011, numri i lindjeve ka qenë 34,262 lindje në vit, deri në vitin 2020 ka rënë në 22,000, që i bie që çdo vit trendi i lindjeve ka rënë në 1200 lindje më pak. Nga viti 2020, kemi një stabilizim dhe nuk kemi rënie të lindjeve.

Sa i përket pyetjes së deputetit Lekaj, po ju them se aty ku janë trashëguar kontratat, ka shumë ngecje dhe shumë probleme. Pra, nuk është çështje e mungesës së mjeteve financiare, por kryesisht

ka problem me kontraktorin e përzgjedhur më herët, i cili jo domosdoshmërisht është i përgjegjshëm dhe i kryen punët. Sa i përket borxhit shtetëror, ne kemi qenë të përkushtuar dhe sa i përket tri viteve të kaluara, disbursimi ka qenë mbi 100 milionë euro, secilin vit. Të punësuarit te niveli qendror janë disa pozita që kanë mbetur të zbrazëta dhe duhet të plotësohen. Ndërsa, sa i përket përmbarimeve, kryesisht janë në nivelin lokal.

Kryetari: Edhe Banka Botërore është tërhequr po ashtu nga garancia para një viti, kështu që në aktgjykim janë munduar edhe për ta shfajësuar, edhe ata kanë shpifur, se e kam parë aktgjykimin.

Hekurani Murati: Kanë qenë paralajmërime të hershme nga ana ime. Pra, kam pasur shkrime, analiza për këtë çështje, por nuk janë marrë për bazë dhe me vetëdije është nënshkruar një kontratë që ia humb shtetit 21 milionë dhe tash po paguan fatura, sikurse me shumë e shumë kontrata të tjera të domosdoshme. Po, ne edhe gjatë fushatës zgjedhore, njëra nga çështjet kryesore që patën ngritur sa i përket mbështetjes së sektorit privat. Pra, përveçse do t'i linim lirshëm të punojnë, është që edhe mos t'iu mbesim borxh për punën që e kanë kryer bizneset, pra sektori privat. Faturat përkundër punës që është kryer, janë dorëzuar në organizatat buxhetore, por pagesa nuk është kryer dhe ka pasur shumë fatura që kanë shkuar mbi 30 ditë vonesë dhe nuk është kryer pagesa. Ne e kemi gjetur një gjendje ku vetëm shpronësimet kanë qenë mbi 180 milionë euro dhe fatura të papaguara dhe kombinime të tjera, nëse nuk gaboj, diku mbi 170 milionë të tjera në nivel lokal dhe kjo shifër në nivel qendror, faturat e papaguara më të vjetra se 30 ditë, kanë rënë dukshëm, te shifra 20 milionë.

Kryetari: Megjithatë, në nivelin qendror ka rënie të theksuar, duke e krahasuar me vitin 2021, mirëpo problematikat kryesore që kemi trashëguar ka qenë në vitin 2020 e sidomos te shpronësimet. Pra, ka qenë rreth 180 milionë euro, ndërkaq ka edhe tek organizata shoqërore një sërë milionash, por kryesore është ndaj personave fizikë dhe ndaj bizneseve, personave juridikë janë krijuar mundësitë për shlyerje të obligimeve dhe nuk ka obligime të tilla. Pra, mbikëqyrja për ta parë sa është efektive, kemi gjetur një indikator i cili izolon të gjithë shpjeguesit tjerë dhe një nga ta mund të jetë, meqenëse këto dallime në interpretime ndërmjet vlerës reale dhe nominale është përpjesëtimi i të hyrave tatimore nominale përmes GDP-së, sepse reflekton po ashtu edhe rritjen e çmimeve dhe unë përpjesëtova në vitin 2003, kemi 26% në raport me GDP-në nominale që trendi i viteve paraprake ka qenë 23 apo 24% në raport me GDP-në nominale, që efektivisht, nëse është si indikator, është rritur nga 24% në 26%, në raport me GDP-në nominale në të hyra tatimore dhe kjo përkthehet diku në 300 milionë të hyra tatimore. Tash, normalisht mbeten dy agjenci që po mbledhin të hyra në Kosovë, Dogana e Kosovës dhe ATK. ATK-ja mbledh edhe TVSH-në e brendshme, por e vërteta është që në vitin 2023 janë mbledhur 834 milionë euro nga ATK, që është një shifër më e madhe se në vitin 2022 për 122 milionë euro. E dyta, është te Dogana e Kosovës, 1653 milionë euro të mbledhura në vitin 2023, më shumë se viti 2019 rreth 600 milionë euro. Te tatimi në të ardhura personale, ju raportuat se ka pasur një rritje dhe për t'iu shmangur keqkuptimeve, unë ju kam drejtuar ATK- së me pyetje, sa ka pasur tatim në vitin 2014-2024, dhe mua më është raportuar kështu: në vitin 2023 ka pas 405 mijë llogari që kanë pagur, në vitin 2024, 420 mijë, ndërsa në vitin 2019, 320 mijë, dhe ne i kemi 100 mijë tatimpagues më shumë.

Hekuran Murati: Ne mund të supozojmë, sepse nuk kemi raste konkrete për të adresuar, megjithatë një trend që vërehet, është çështja e viteve zgjedhore, sa herë ka pasur vite zgjedhore, ka pasur edhe një performancë më të dobët në mbledhjen e të hyrave.

Kryetari: Po më intereson fitimi i deklaruar i bizneseve, ku ka shkuar ai fitim? Në bazë të të dhënave, unë po e shoh se rreth 3 miliardë euro kanë qenë të hyrat dhe po aq kanë qenë shpenzimet buxhetore. A mund ta konfirmosh këtë?

Hekuran Murati: Po, ashtu është.

Kryetari: Në vitin 2009, janë marrë 200 milionë euro dividendë nga Telekomit për t'i mbuluar shpenzimet qeveritare, të cilat kanë shkuar në paga ose shpenzime tjera. Pra, është shkatërruar Telekomit për të mbuluar shpenzimet qeveritare dhe kështu ka vazhduar nëpër vite. Mbi 400 milionë euro janë marrë dividendë nga Telekomit, prandaj është në këtë gjendje, Telekomit.

Hekuran Murati: Po, ashtu është. Mjetet që Telekomit ka pasur që të investojë për ngritje të infrastrukturës, i është dhënë moratorium nga Qeveria, që të mos investojë dhe ato mjete janë marrë prej Qeverisë, si dividendë e deklaruar.

Kryetari: Sa është paga mesatare bruto në sektorin publik, a ka pasur rritje të pagave?

Hekuran Murati: Si mesatare janë shtuar 114 milionë euro. Në vitin 2023, më shumë sesa në vitin paraprak si shpenzim në paga. Paga mesatare patjetër që ka rritje.

Kryetari: Te kategoria ekonomike, subvencione dhe transfere, për vitin 2023 keni thënë se janë shpenzuar 1 miliard e 479 milionë euro, ndërsa nëse e krahasojmë me vitin 2019, kanë qenë 605 milionë euro. Kërkoj një sqarim në lidhje me këtë kategori. Ndërsa, sa u përket ndërmarrjeve publike, sa i përket pjesës së subvencioneve, edhe këtu kërkoj një sqarim. Një raport të detajuar, sa i përket detyrimeve ndaj shpronësimeve dhe grantet e bujqësisë.

Hekuran Murati: Do t'ua dërgojmë edhe me shkrim, por sa i përket informative të shpronësimit apo te bujqësia, është Thesari që e bën konsolidimin e informative të marra nga Ministria përkatëse e Infrastrukturës dhe nuk mund t'i ndryshojë.

Kryetari konstatoi që pikat në vijim, të shtyhen për një mbledhje të radhës. Po ashtu, pyeti se a ka diçka në pikën të ndryshme. Meqë nuk pati, e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit